



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "FAN S. NOLI"
KORÇË

STATUTI

I

UNIVERSITETIT "FAN S. NOLI", KORÇË

(I AZHURNUAR)

Miratuar në mbledhjen e datës 09.05.2008, të Senatit Akademik.

KREU I

DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1

Hartimi dhe përmbajtja e statutit

1. Ky Statut është hartuar në zbatim të nenit 39 të Ligjit nr. 9741, dt. 21. 05. 2007 “Për Arsimin e Lartë në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, dhe është zbatim konkret i këtij Ligji, si dhe i gjithë legjislacionit tjetër në fuqi për arsimin e lartë publik.

Statuti pasqyron riorganizimin e strukturimit të brendshëm të Universitetit “Fan S.Noli” dhe të programeve të studimit në bazë të nenit 83 të Ligjit të sipërcituar.

2.Statuti i Universitetit “Fan S.Noli” i Korçës (shkurt UK) përmban normat kryesore që rregullojnë veprimtarinë e institucionit, si organizimi, veprimtaria dhe puna e strukturave përbërëse, e autoriteteve dhe organeve drejtuese, zgjedhja ose përzgjedhja e tyre, nivelet e delegimit të autoritetit nga organet drejtuese e administruese, periudhat e kryerjes së vlerësimit të brendshëm të strukturave dhe të programeve të studimit, detyrat dhe të drejtat e personelit akademik, joakademik dhe të studentëve, si edhe detyra të tjera që rregullojnë veprimtarinë e këtij institucioni. Mbi bazën e këtij statuti, si dhe të udhëzimeve të ndryshme, përgatiten rregulloret e UK-së, si dhe të organeve të tij.

Neni 2

Pozita juridike

1.UK është institucion publik i Arsimit të Lartë me karakter mësimor e shkencor, i njohur me ligj, si i tillë.

2.Ai është krijuar me vendim të Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë nr.5, dt. 07. 01.1992, mbi bazën e Institutit të Lartë Bujqësor (ILB), themeluar në vitin 1971. Ai funksionon e akreditohet në përputhje me ligjin nr. 9741, dt. 21. 05. 2007 “Për Arsimin e Lartë në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, në këtë Statut, si dhe në rregulloret që miratohen në zbatim të tij.

3.Universiteti i Korçës mban emrin zyrtar “Fan S. Noli”, dhënë në vitin 1994, me vendim të Këshillit të Ministrave.

4.Selia Qendrore e UK-së ndodhet në adresën: Shëtitore “Rilindasit”, Korçë.

5.Stema, vula dhe simbole të tjera janë sipas aneksit bashkëlidhur këtij Statuti.

6.Fakultetet e UK-së kanë vulat e tyre zyrtare dhe miratojnë simbolet përkatëse, nisur nga ky model.

Neni 3

Misioni dhe qëllimet e universitetit “Fan S. Noli” të Korçës

1. UK në gjithë veprimtarinë e tij ka për mision kryesor të krijojë, të transmetojë, të zhvillojë dhe të mbrojë dijet me anë të mësimdhënies, kërkimit shkencor dhe shërbimeve. Këtë mision ai e realizon përmes këtyre synimeve:

a)të përgatisë profesionalisht specialistë të lartë në fushat që mbulon në të gjitha programet e studimit, nëpërmjet mësimdhënies dhe praktikave profesionale, duke përmbushur të gjitha detyrat që rrjedhin nga nënshkrimi i Deklaratës së Bolonjës.

b)të formojë shkencëtarë të rinj në fusha të ndryshme parësore, duke marrë parasysh drejtimit kryesor të zhvillimit të Rajonit, nëpërmjet kërkimit shkencor dhe veprimtarisë botuese ;

c)të kryejë studime shkencore për të zhvilluar programet e studimit të shkencave që lëvron dhe të ofrojë shërbime për zgjidhjen e problemeve më të rëndësishme që ka Rajoni i Korçës dhe më gjerë;

ç)të kryejë kualifikimin e vazhdueshëm të specialistëve të lartë të fushave të ndryshme, duke u kthyer në një qendër e rëndësishme kualifikimi dhe zhvillimi të teknologjive bashkëkohore.

2. UK u siguron punonjësve akademikë pavarësinë e kërkimit dhe lirinë e mësimdhënies, sipas dispozitave të këtij statuti dhe në përputhje me legjislacionin në fuqi.

3.UK lëshon diploma dhe jep certifikata e tituj të tjerë në përputhje me nivelin e formimit të kryer.

4.UK garanton shprehjen e lirë të ideve dhe i siguron personelit dhe studentëve mundësi të barabarta për punë dhe studim.

Neni 4

Autonomia institucionale dhe liria akademike

1.UK, në cilësinë e një institucioni të arsimit të lartë, sipas nenit 3 të Ligjit nr. 9741, dt. 21. 05. 2007 “Për Arsimin e Lartë në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, ka autonomi dhe liri akademike në mësimdhënie dhe kërkim shkencor.

2.Në përputhje me parimin bazë të autonomisë, UK-së:

a) i njihet e drejta e zgjedhjes së autoriteteve dhe organeve drejtuese të tij në shkallë institucioni, në fakultete e departamente;

b)e drejta e emërimeve të autoriteteve sipas ligjit, akteve nënligjore dhe rregullores së zgjedhjeve;

c) e drejta për hartimin dhe miratimin e programeve të studimit dhe të kurrikulave në përputhje me strategjitë kombëtare të zhvillimit të arsimit të lartë dhe parimet e hapësirës evropiane të asimit të lartë;

ç)e drejta për hartimin dhe zhvillimin e pavarur të projekteve të kërkimit;

d)e drejta për të bërë marrëveshje të pavarura me Qeverinë ose me organizma të tjera në fusha të tilla, si: trajnime, kualifikime dhe projekte kërkimore;

dh) e drejta e anëtarësimit në shoqata e organizata kombëtare e ndërkombëtare të arsimit të lartë;

e)e drejta për të bërë marrëveshje me institucione, shoqëri biznesi ose organizata të tjera vendase dhe të huaja, publike ose private;

ë)e drejta për të mbledhur dhe administruar fonde publike dhe të ardhura të tjera, që ka universiteti në përputhje me ligjet etj.;

f)e drejta e pranimit dhe përcaktimit të kriterëve për studentët e rinj në programet e studimit në nivel universitar dhe pasuniversitar;

g) e drejta e përzgjedhjes së personelit akademik dhe joakademik;

gj) e drejta e përdorimit të tokës, ndërtesave dhe pasurive të tjera të dhëna nga shteti ose dhurues të ndryshëm, si dhe e drejta e zotërimit të çdo lloj pasurie tjetër sipas legjisllacionit në fuqi.

3.UK financohet nga buxheti i shtetit sipas legjisllacionit në fuqi dhe buxheti i tij është zë më vete në buxhetin për arsimin. Ai ka të drejtë të krijojë e të përdorë të ardhurat që realizohen nga veprimtaria e tij, në përputhje me legjisllacionin në fuqi.

4.Fondet për kërkimin shkencor në UK përcaktohen si zë më vete në buxhetin e tij dhe administrohen nga ky institucion në përputhje me dispozitat përkatëse të Ligjit për Arsimin e Lartë.

5.Liria akademike në UK shprehet në lirinë e mësimdhënies, lirinë e kërkimit shkencor, lirinë e krijimit, në përputhje me dispozitat e Ligjit për Arsimin e Lartë.

6.Liria akademike ushtrohet në përputhje me programet e studimit të hartuara e miratuara nga organet përkatëse të universitetit për të gjitha ciklet e studimeve që ka ai.

7.UK është institucion laik.

Neni 5

- 1.UK është person juridik, i njohur si i tillë me ligj.
- 2.Rektori është organ monokratik i këtij personi juridik dhe vepron në emër të UK-së, brenda kufijve të të drejtave që i njohin ligjet, ky statut, Rregullorja e universitetit dhe akte të tjera ligjore e nënligjore.

Neni 6

- 1.Të gjitha mjediset (ndërtesa e troje) që shteti i ka dhënë në përdorim UK-së, si dhe çdo mjedis tjetër, që do t'i jepet në të ardhmen sipas ligjit gëzojnë paprekshmërinë e siguruar nga shteti.
- 2.Kjo paprekshmëri përfshin moslejimin e ndërhyrjes në mjediset e universitetit apo të përdorimit të tyre nga çdo person fizik e juridik, mosndërhyrjen e pushtetit qendror e vendor dhe të organeve të rendit publik pa kërkesën apo lejën nga Rektori i Universitetit ose personi i autorizuar prej tij.
- 3.Vetëm në rastet e kryerjes së një krimi flagrant dhe në rastet e një fatkeqësie natyrore, organet e rendit publik ndërhyjnë dhe pa lejën e rektorit.
- 4.Për çdo cenim të paprekshmërisë, UK-së i lind e drejta e denoncimit të shkeljes dhe kërkesës për ndëshkimin e saj sipas dispozitave ligjore.

KREU II

STRUKTURA ORGANIZATIVE E UNIVERSITETIT “FAN S. NOLI”

Neni 7

Universiteti

- 1.Struktura organizative e UK-së përcaktohet nga lloji i programeve të studimit që ofron.
- 2.UK përfaqëson një strukturë, të përbërë dhe të integruar, në mënyrë që të realizojë një arsimim të lartë, zhvillim të dijeve, të shkencës, të profesioneve dhe transmeton njohuri në fusha dhe disiplina shkencore dhe profesionale, duke u bazuar në kërkim dhe njohuri teknologjike bashkëkohore.

3.Në përputhje me misionin kryesor të përcaktuar në këtë statut, UK siguron raportet e përshtatshme ndërmjet mësimdhënies, kërkimit shkencor dhe shërbimeve që ofron.

4.UK, për të kryer veprimtari të arsimit dhe kërkimit me interes të përbashkët, ka të drejtë të bashkëpunojë me institucione të tjera publike dhe private.

5.UK përbëhet nga njësi kryesore, njësi bazë, njësi ndihmëse (EDE-Ekonomia Didaktike Eksperimentale, Bibliotekat, Laboratorët).

Neni 8

Fakultetet

1. Fakulteti është njësi kryesore, që bashkërendon mësimdhënien, kërkimin shkencor dhe zhvillimin kulturor në fusha mësimore-shkencore të përafërta ose të ndërthurura.

2. Fakulteti ofron programe të studimeve të llojeve e të niveleve të ndryshme, në përfundim të të cilave përfitohet diplomë.

3. (shfuqizuar)

4.UK përbëhet nga këto njësi kryesore:

a. Fakulteti i Bujqësisë

b. Fakulteti i Ekonomisë

c. Fakulteti i Edukimit dhe Filologjisë

d. Fakulteti i Shkencave Natyrore dhe Shkencave Humane

e. Filiali i Universitetit "Fan S. Noli" në Pogradec.

Neni 9

Departamentet

1.Departamenti është njësi bazë mësimore-kërkimore në UK, që përfshin fusha kërkimi homogjene ose të përafërta dhe grupon disiplinat mësimore përkatëse. Departamenti drejtohet nga Përgjegjësi i Departamentit.

2.Departamenti nxit, bashkërendon dhe administron veprimtaritë e mësimdhënies, veprimtaritë kërkimore-botuese ose artistike, duke respektuar liritë akademike të personelit akademik.

3. (shfuqizuar)

4. Departamenti organizohet në grupe mësimore e kërkimore. Grupi mund të jetë edhe vetëm kërkimor. Titullarët e grupeve duhet të kenë, së paku, gradën

shkencore “Doktor” dhe përzgjidhen me konkurrim të hapur, të drejtuar nga një komision ad hoc, i ngritur nga Këshilli i Profesorëve. Titullari i njësisë bazë i propozon autoritetit drejtues të njësisë kryesore emërimin e kandidatit të renditur në vendin e parë të listës nga komisioni ad hoc, për një periudhë 4-vjeçare.

5.Fakultetet e UK-së përbëhen nga këto njësi bazë (departamente).

➤ Fakulteti i Bujqësisë:

- a.Departmenti i Hortikulturë-Agrobiznesit
- b.Departmenti i Agronomisë
- c. Departamenti i Biokimi-Agroushqimit

➤ Fakulteti Ekonomik:

- a.Departmenti i Financë-Kontabilitetit
- b.Departmenti i Menaxhimit
- c.Departmenti i Marketing-Turizmit

➤ Fakulteti i Edukimit dhe Filologjisë:

- a.Departmenti i Gjuhë-Letërsisë
- b.Departmenti i Gjuhëve të Huaja
- c.Departmenti i Histori-Gjeografisë
- d.Qendra e Ekselencës “FEF”

➤ Fakulteti i Shkencave Natyrore dhe Shkencave Humane:

- a. Departamenti i Matematikës
 - b. Departamenti i Informatikë-Fizikës
 - c. Departamenti i Infermierisë
 - d. Departamenti i Shkencave Sociale
- Filiali i Universitetit “Fan S. Noli” në Pogradec.

Neni 10

Filialet

1.Universiteti i Korçës mund të hapë filiale të tij në rajone të tjera, jashtë selisë qendrore, për të ofruar programe të studimeve, kërkim shkencor e shërbime të ndryshme, ashtu siç përcaktohet në nenin 11 të ligjit nr.9741, dt.21.05.2007 “Për Arsimin e Lartë në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.

Hapja e filialit bëhet:

a) me vendim të Këshillit të Ministrave, në rastin kur hapet si njësi e veçantë në strukturën e universitetit;

b) me propozim dhe vendim të Senatit Akademik, në rastin kur hapet si pjesë përbërëse e njësisë të selisë qendrore të universitetit.

2. Kriteret minimale për të hapur një filial janë:

a) të plotësojë standardet akademike në lidhje me kualifikimin e pedagogëve;

b) të ketë një infrastrukturë të përshtatshme dhe të mjaftueshme për shërbimin që do të ofrohet;

c) të ketë fonde të mjaftueshme buxhetore për të përballuar kostot përkatëse.

3. Mënyra e funksionimit të filialit në raport me Universitetin dhe fakultetin përkatës parashikohet në rregulloren e UK-së.

Neni 11

Këshilli i Profesorëve

1. Për organizimin dhe drejtimin e studimeve të doktoratës dhe të kualifikimit shkencor e pedagogjik pas doktorates, ngrihet Këshilli i Profesorëve (KP) në nivel universiteti.

2. Këshilli i Profesorëve drejtohet nga Kryetari, i cili zgjidhet me votim të fshehtë të të gjithë anëtarëve. Drejtimi i KP bëhet me rotacion për një vit akademik.

3. Këshilli i Profesorëve përbëhet nga të gjithë profesorët, me kohë të plotë, të Universitetit. Lista e anëtarëve të KP, hartohet dhe korrigjohet në përputhje me ndryshimet e mundshme nga Senati Akademik.

Numri minimal i anëtarëve të KP-së duhet të jetë shtatë. Në rast se numri i profesorëve të Universitetit është më i vogël se shtatë, për të arritur këtë numër në KP mund të ftohen profesorë të fushave të afërta nga universitetet e tjera brenda ose jashtë vendit.

Propozimet për kandidatët që ftohen të bëhen anëtarë të KP, bëhen nga fakultetet përkatëse dhe dorëzohen në Rektoratin e UK-së, i cili pasi i diskuton ato, ia përcjell për miratim Senatit Akademik.

4. KP mblidhet në kohën më të shkurtër të mundshme, çdo herë që në përputhje me legjislacionin në fuqi kërkohet angazhimi i tij. Mbledhjet e KP thirren, organizohen dhe drejtohen nga kryetari. Thirrja e mbledhjes së KP mund të bëhet edhe me kërkesë të një të tretës së anëtarëve të tij.

5. Këshilli i Profesorëve ushtron kompetencat e përcaktuara në aktet nënligjore përkatëse që kanë lidhje me të, si dhe në rregulloren e tij të brendshme të funksionimit.

6. Gjatë funksionimit dhe ushtrimit të kompetencave, si dhe në gjithë veprimtarinë e tij, Këshilli i Profesorëve i UK-së bazohet dhe vepron në përputhje me Ligjin nr. 9741, dt. 21.05.2007 "Për Arsimin e Lartë në

Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, me aktet e tjera ligjore e nënlige në fuqi, me Statutin dhe Rregulloren e Universitetit të Korçës, si dhe me rregulloren e funksionimit të tij, që miratohet nga Senati Akademik.
7.Paraqitja më e detajuar e funksionimit të Keshillit të Profesorëve bëhet në rregulloren e brendshme të funksionimit të tij.

KREU III

DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I UNIVERSITETIT “FAN S.NOLI”

Neni 12

Organet drejtuese dhe administrative të Universitetit

Organet drejtuese dhe administruese të UK-së janë :

- a)senati akademik;
- b)rektorati;
- c)këshilli i administrimit;
- ç) këshilli i profesorëve;
- d)këshilli i etikës;
- e)këshilli i fakultetit.

Neni 13

Senati akademik

1.Senati Akademik i UK-së është organ kolegjal vendimmarrës, që përcakton politikat e zhvillimit të Universitetit, programon, bashkërendon, drejton dhe kontrollojnë veprimtaritë e mësimdhënies dhe të kërkimit shkencor dhe vlerëson efikasitetin e tyre. Senati akademik kryesohet nga rektori dhe mbledhet periodikisht.

2.Senati Akademik përbëhet nga anëtarë të zgjedhur nga personeli akademik, nga personeli joakademik dhe nga studentët, sipas mënyrës së përcaktuar në ligjin nr. 9741, dt. 21. 05. 2007 “Për Arsimin e Lartë në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, dhe në rregulloren e zgjedhjeve.

3.Anëtarët e Senatit Akademik, të zgjedhur nga personeli akademik duhet të kenë të paktën gradën shkencore “Doktor”. Përfaqësimi i njësive të tjera që nuk kanë anëtarë të zgjedhur bëhet me vendim të Senatit Akademik.

4.Në bazë të nenit 14 dhe të neneve të tjera të ligjit “Për Arsimin e Lartë në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, Senati akademik kryen këto funksione:

a) siguron respektimin e parimeve të autonomisë dhe të mundësive të barabarta të lirisë akademike e të kërkimit, si dhe të drejtat e studentëve;

b) miraton planin disaveçar të zhvillimit të Universitetit dhe programin vjetor të veprimtarive të tij.

c) vendos me shumicën e votave të anëtarëve të tij projektbuxhetin e institucionit, pasi merr miratimin nga këshilli i administrimit;

ç) miraton ndarjen e burimeve financiare;

d) miraton projektstatutin e Universitetit me dy të tretat e votave të anëtarëve të tij;

dh) miraton rregulloret e universitetit, që janë kompetencë e tij, sipas përcaktimeve të bëra në ligjin nr.9741, datë 21.05.2007 “Për Arsimin e Lartë në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, si dhe në këtë statut.

e) vlerëson dhe miraton programet e reja të studimit, të kërkimit e të zhvillimit apo pjesë të tyre, si dhe hapjen, ndryshimin e mbylljen e njësive mësimore ose kërkimore.

ë) vlerëson, garanton dhe mban përgjegjësi për sigurimin e brendshëm të cilësisë në Universitet, në përputhje me standardet shtetërore. Për vlerësimin e efikasitetit të veprimtarive mësimore, kërkimore apo artistike, si dhe të veprimtarive administrative dhe financiare të institucionit, në UK ngrihet njësia e sigurimit të brendshëm të cilësisë, që miratohet nga Senati Akademik.

f) vlerëson veprimtarinë mësimore-kërkimore dhe botuese të personelit akademik;

g) siguron që zhvillimi dhe vlerësimi i të gjitha provimeve bëhet në përputhje me standardet e Universitetit, që sigurojnë cilësinë dhe transparencën e duhur;

gj) miraton raportin vjetor të veprimtarisë mësimore-kërkimore, si dhe atë financiar, në një mbledhje të hapur për gjithë personelin akademik administrativ dhe për studentët.

5. Senati akademik kërkon mendimin e këshillit të administrimit për probleme që janë në kompetencë të këtij të fundit.

6. Senati akademik, veç funksioneve kryesore, kryen edhe këto funksione të tjera:

a) i propozon Ministrit të Arsimit dhe Shkencës hapjen apo mbylljen e programeve të reja në universitet;

b) i propozon Ministrit të Arsimit dhe Shkencës kuotat e pranimeve në universitet, si dhe tarifën e regjistrimit dhe të studimeve;

c) përcakton kritere të veçanta në përzgjedhjen e kandidateve për t'u pranuar si student në ciklin e parë të studimeve, sipas propozimeve të këshillave të fakulteteve;

ç) përcakton kriteret e pranimi për kandidate në ciklin e dytë dhe të tretë të studimeve, sipas propozimeve të këshillave të fakulteteve, si dhe i propozon Ministrit të Arsimit dhe Shkencës kuotat përkatëse;

d)miraton në parim marrëveshjet apo kontratat e bashkëpunimit me të tretët, që do të nënshkruajë Rektori, në emër dhe për llogari të universitetit;

dh)miraton krijimin e qendrave apo kurseve të posaçme, si dhe projektet e tjera të shërbimit që ofrohen nga fakultetet, bazuar në propozimin e Këshillit të Fakultetit përkatës;

e)në punën e tij krijon komisione (të përhershme ose të përkohshme) për probleme që i konsideron të rëndësishme, me anëtarë të senatit akademik dhe të ftuar, sipas përcaktimeve në rregulloren e tij.

7.Mandati i anëtarit të senatit akademik mbaron kur:

a)përmbushet afati i mandatit;

b)jep dorëheqjen;

c)largohehet nga UK;

ç)vdes;

d)bëhet e pamundur nga ana fizike apo mendore që të ushtrojë funksionin;

dh)nuk merr pjesë 3 herë radhazi, pa shkaqe të arsyeshme, në mbledhjet e senatit akademik;

e)kur dënohet me një vendim gjyqësor të formës së prerë.

8.Plotësimi i vendit të mbetur vakant bëhet sipas renditjes në listën përkatëse të kandidatëve gjatë votimit për Senatin Akademik. Kur nuk ka kandidatë të tillë, atëherë Rektori i Universitetit thërret zgjedhjet për anëtarë të senatit akademik, sipas pikës 3.5 të Rregullores “Për organizimin e zgjedhjeve për autoritetet dhe organet drejtuese në Universitetin “Fan S. Noli”, Korçë.

9.Mënyra e thirrjes së mbledhjeve të Senatit Akademik, rendi i ditës, votimi dhe çështje të tjera të lidhura me to parashikohen në rregulloren e universitetit.

10.Numri, përbërja dhe përfaqësimi në Senatin akademik përcaktohen në rregulloren e UK-së.

Neni 14

Rektorati

1.Rektorati është organ kolegjal ekzekutiv i universitetit që përbëhet nga:

a) rektori

b) zëvendësrektorët;

c) dekani i çdo fakulteti;

d) kancelari i universitetit;

Rektorati kryesohet nga rektori.

2.Në bazë të nenit 15 të ligjit nr.9741, dt.21.05.2007 “Për Arsimin e Lartë në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, Rektorati ushtron këto kompetenca:

a)harton planin disavjeçar të zhvillimit të UK-së;

b)harton programin vjetor të veprimtarive, si dhe ndjek zbatimin e tij pas miratimit në senatin akademik;

c)formulon kriteret për shpërndarjen e burimeve financiare, materiale dhe njerëzore;

ç)parashtron përparësitë mes kërkesave konkurruese për financime mes njërive kryesore të institucionit;

d)harton dhe propozon projektbuxhetin për miratim në senatin akademik;

dh)harton planin për investime, kontratat dhe marrëveshjet, që janë kompetencë e tij;

e)paraqet rekomandime për projektet për programet e studimeve, të kërkimit shkencor dhe ndryshimet e nevojshme strukturore për realizimin e tyre;

ë)zbaton të gjitha vendimet e miratuara në senatin akademik dhe në këshillin e administrimit;

f)monitoron dhe publikon rezultatet e vlerësimit të veprimtarive të institucionit;

g)përgatit marrëveshjen ndërmjet UK-së dhe Ministrisë së Arsimit dhe të Shkencës për rregullat e financimit;

gj)propozon strukturën e përgjithshme dhe numrin e personelit të Universitetit për të gjitha nivelet;

h)përgatit rregulloren e tij të punës, në të cilën përcaktohen detyrat e secilit punonjës, përkatësisht sipas punës që kryejnë, me përjashtim të atyre punonjësve që i kanë të përcaktuara ato në akte të tjera. Rregullorja miratohet nga senati akademik.

i)ofron infrastrukturën dhe shërbimin administrativ për mbarëvajtjen e funksionimit të organeve kolegjiale dhe monokratike të universitetit.

j)ushtron kontrole tematike, të organizuara apo spontane në njësitë e universitetit për përmbushjen e qëllimeve të tij, si dhe për zbatimin e akteve të autoriteteve dhe organeve drejtuese të universitetit.

3.Rektorati kërkon mendimin e senatit akademik dhe të këshillit të administrimit për aspekte të kompetencës së këtyre të fundit.

4.Rektorati harton raportin vjetor të veprimtarisë kërkimore-shkencore dhe financiare dhe ia paraqet atë për miratim senatit akademik dhe këshillit të administrimit brenda datës 20 dhjetor të çdo viti.

5.Rektorati ka të drejtë t'ia delegojë kompetencat personelit apo organeve të tjera të Universitetit, në përputhje me rregulloren e tij.

6.Rektorati raporton një herë në semestër në Senatin Akademik dhe në këshillin e Administrimit.

Këshilli i administrimit

1.Këshilli i Administrimit është organ kolegjal vendimmarrës i UK-së që mbikëqyr e kontrollon veprimtaritë që lidhen me menaxhimin administrativ, financiar, ekonomik dhe të pronave të universitetit.

2.Këshilli i Administrimit përbëhet nga 9 anëtarë: 4 anëtarë të zgjedhur nga personeli akademik, 4 anëtarë të caktuar nga Ministri i Arsimit dhe i Shkencës dhe një përfaqësues i zgjedhur nga Këshilli i Studentëve të Universitetit.

3.Anëtarët e Këshillit të Administrimit, të zgjedhur drejtpërdrejt nga personeli akademik i çdo njësie kryesore, duhet të kenë së paku gradën shkencore “Doktor”. Ata zgjidhen sipas mënyrës së përcaktuar në Ligjin nr. 9741, dt. 21. 05. 2007 “Për Arsimin e Lartë në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, dhe në rregulloren e zgjedhjeve.

4.Në bazë të nenit 16, të Ligjit nr.9741, dt.21.05.2007 “Për Arsimin e Lartë në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, Këshilli i Administrimit ka këto funksione kryesore:

- a)miraton kriteret për ndarjen e burimeve financiare;
- b)miraton, me kërkesën e senatit akademik, projektbuxhetin e UK-së me dy të tretat e votave;
- c)vlerëson efikasitetin e përdorimit të fondeve nga Buxheti i Shtetit ose burime të tjera të ligjshme dhe publikon rezultatet e vlerësimit;
- ç)miraton strukturën dhe numrin e personelit të UK-së për të gjitha nivelet;
- d)miraton planin vjetor financiar të paraqitur nga rektorati;
- dh)vlerëson planin e zhvillimit të institucionit dhe programin vjetor të veprimtarive të tij;
- e)miraton rregulloren e brendshme për administrimin, financat dhe kontabilitetin;
- ë)miraton rregulloren e funksionimit të tij.

5.Këshilli i Administrimit kryen edhe këto detyra:

- a)i propozon Ministrin të Arsimit dhe Shkencës kriteret për përcaktimin e nivelit të pagave të punonjësve mësimorë dhe jomësimorë, si dhe tarifën e orës mësimore;
- c)përcakton pagesat për kontratat e punës me kohë të pjesshme, bazuar në kualifikimin e të punësuarit dhe statusin, i diplomuar apo student;
- c)miraton paraprakisht tarifën e regjistrimit dhe të studimeve në universitet dhe ia përcjell për miratim të mëtejshëm Senatit Akademik;
- d)informon Senatin Akademik dhe Rektorin për situatën financiare dhe projektet përkatëse për të gjithë universitetin.

6.Mandati i anëtarit të Këshillit të Administrimit mbaron kur:

- a)përmbushet afati i mandatit;

b) jep dorëheqjen;
c) largohet nga UK, për anëtarët e caktuar sipas pikës 4, gërmat “a” dhe “c” të nenit 16, të Ligjit nr.9741, dt.21.05.2007 “Për Arsimin e Lartë në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar;

ç) vdes;

d) bëhet e pamundur nga ana fizike apo mendore që të ushtrojë funksionin;

dh) nuk merr pjesë, për 3 herë radhazi, pa shkaqe të arsyeshme, në mbledhjet e Këshillit të Administrimit;

e) lirohen me akt të Ministrit të Arsimit dhe Shkencës anëtarët e emëruar sipas pikës 5, të nenit 16, të Ligjit nr.9741, dt.21.05.2007 “Për Arsimin e Lartë në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.

7. Rektori dhe kancelari i UK-së kanë të drejtë të marrin pjesë në mbledhjet e Këshillit të Administrimit, pa të drejtë vote, kur e vlerësojnë ata vetë, si dhe kur thirren nga ky këshill.

8. Këshilli i Administrimit i Universitetit të Korçës përbëhet nga 9 anëtarë.

Përbërja e tij është si më poshtë vijon:

- një anëtar, përfaqësues i Fakultetit të Edukimit dhe Filologjisë;
- një anëtar, përfaqësues i Fakultetit të Shkencave Natyrore dhe Shkencave Humane;
- një anëtar, përfaqësues i Fakultetit të Bujqësisë;
- një anëtar, përfaqësues i Fakultetit Ekonomik;
- një anëtar, përfaqësues i studentëve të universitetit;
- katër anëtarë të caktuar nga Ministri i Arsimit dhe i Shkencës.

Mandati i anëtarëve të Këshillit të Administrimit është 4-vjeçar.

9. Këshilli i Administrimit mbledhet në seanca të zakonshme, të pakten 1 herë në 6 muaj. Rendi i ditës propozohet nga kryetari i Këshillit të Administrimit dhe miratohet në çdo rast nga këshilli.

Këshilli i Administrimit mbledhet dhe në seanca të jashtëzakonshme, me një rend të caktuar dite, në keto raste:

- me nismën e kryetarit të Këshillit të Administrimit;
- me kërkesë të Rektorit ose të Kancelarit të universitetit, e cila i paraqitet kryetarit të Këshillit të Administrimit;
- me kërkesë me shkrim të të pakten 1/3-ës së anëtarëve të këshillit.

10. Thirrja e mbledhjeve të Këshillit të Administrimit behet nga kryetari i këshillit, nëpërmjet nje lajmërimi që bëhet të paktën 4 ditë para datës së mbledhjes dhe i cili duhet të përmbajë detyrimisht rendin e ditës dhe materialin përkatës bashkëngjitur (kur ka të tillë).

Në rast të thirrjes me urgjencë të mbledhjeve, lajmërimi duhet të bëhet të paktën 24 orë para orës së caktuar për mbledhjen. Në këtë rast, rendi i dites dhe materiali

përkates u komunikohet anëtareve bashkë me lajmërimin (në qoftë se është e mundur) ose në momentin e fillimit të mbledhjes.

11. Si rregull, mbledhja e Këshillit të Administrimit zhvillohet kur janë të pranishëm më shumë se gjysma e anëtarëve të tij; vendimet e këshillit merren me shumicën e votave të të gjithë anëtarëve (të pranishëm ose jo).

Për çështje të veçanta të përcaktuara në ligj apo në akte të tjera ligjore e nënligjore, për të cilat duhet të merren vendime me të paktën 2/3-ën e votave të të gjithë anëtarëve (të pranishëm ose jo), mbledhja e këshillit zhvillohet kur janë të pranishëm të paktën 2/3 e anëtarëve të këshillit.

12.Radha e diskutimit të çështjeve është ajo e përcaktuar në lajmërimin për mbledhjen dhe që mund të ndryshohet në fillim të mbledhjes nga këshilli. Paraqitja e çështjeve për diskutim bëhet nga kryetari, i cili mund t'ia ngarkojë këtë detyrë njërit prej anëtarëve të këshillit.

13.Për marrjen e vendimeve mirëkuptimi dhe votimi i hapur është procedurë e zakonshme. Mënyra e votimit të fshehtë është e detyrueshme në rastin e votimeve nominale dhe në rastet kur kjo mënyrë votimi kërkohet nga kryetari ose vetë këshilli.

Vendimet e Këshillit të Administrimit bëhen publike, me përjashtim të atyre , për të cilat këshilli vendos me shumicë votash të mos publikohen.

14.Në funksionimin dhe ushtrimin e kompetencave si dhe në gjithë veprimtarinë e tij, Këshilli i Administrimit bazohet dhe vepron në përputhje me Ligjin nr. 9741, dt. 21.05.2007 “Për Arsimin e Lartë në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, me aktet e tjera ligjore e nënligjore në fuqi, me Statutin dhe Rregulloren e Universitetit të Korçës, si dhe me rregulloren e brendshme të funksionimit të tij, që miratohet nga vetë këshilli.

15.Paraqitja me e detajuar e funksionimit të Këshillit të Administrimit bëhet në rregulloren e brendshme të funksionimit të tij.

Neni 16

Këshilli i etikës

1.Këshilli i Etikës i UK-së trajton probleme të etikës së jetës universitare, si dhe shqyrton e u jep zgjidhje ankesave në lidhje me këto çështje.

2.Anëtarët e Këshillit të Etikës përzgjidhen dhe emërohen nga Senati Akademik, nga punonjësit mësimorë me tituj dhe/ose grada, sipas propozimeve të Rektorit.

3.Këshilli i Etikës përbëhet nga 4 anëtarë dhe kryesohet nga Rektori. Njëri prej anëtarëve të këshillit kryen funksionin e sekretarit.

a)Këshilli funksionon në mënyrë kolegjiale dhe merr vendime me shumicë të thjeshtë. Mbledhjet e këshillit thirren nga Rektori, i cili si rregull kryeson seancat dhe

përcakton e mban rregullin në diskutimin e çështjeve. Mbledhjet e këshillit zhvillohen kur janë të pranishëm së paku 2/3 e anëtarëve të tij.

b) Këshilli i Etikës ka funksione këshilluese, të kërkimit, hetimit dhe kontrollit për zbatimin dhe respektimin e normave të Rregullores së Etikës të UK-së; Këshilli i Etikës favorizon ku është e mundur, zgjidhjen me mirëkuptim të mosmarrëveshjeve të mundshme; ai mund t'i propozojë Rektorit veprimin disiplinor kundrejt shkelësve të dispozitave të Rregullores së Etikës të UK-së.

c) Në rast shkeljesh të Rregullores së Etikës, për rastet që parashikohen shprehimisht në të apo të tjera që konsistojnë gjithsesi në shkelje të normave etiko-morale të shoqërisë, Rektori cakton një nga anëtarët e Këshillit të Etikës për të ndërmarrë rolin e ndërmjetësuesit dhe/apo për të nxjerrë në dritë faktet.

ç) Këshilli i Etikës mund të vihet në lëvizje kryesisht ose mbi bazën e një ankese. Ai mban një regjistër, në të cilin shënon të gjitha rastet e shkeljeve që trajton. Mënyra e trajtimit të shkeljeve nga ana e Këshillit të Etikës duhet të jetë përgjithësisht progresive, bazuar mbi natyrën e shkeljes, të rrethanave dhe fakteve që dalin gjatë shqyrtimit.

4. Këshilli i Etikës harton rregulloren e etikës së universitetit, të cilën ia paraqet për miratim Senatit akademik.

5. Mënyra e shqyrtimit të ankesave, vendimet, sanksionet përkatëse, si dhe ekzekutimi i vendimeve në mënyrë të detajuar parashikohen në Rregulloren e Etikës së UK-së.

Neni 17

Këshilli i fakultetit

1. Këshilli i Fakultetit është organ kolegjal vendimmarrës, i cili vendos për problemet më të rëndësishme të fakultetit në fushën e mësimin, kërkimit shkencor dhe atë administrativ. Këshilli i Fakultetit kryesohet nga dekani.

2. Këshilli i Fakultetit përbëhet nga anëtarë të zgjedhur nga personeli akademik, nga personeli joakademik dhe nga studentët. Përbërja e tij dhe mënyra e zgjedhjes përcaktohen në Ligjin nr.9741, dt.21.05.2007 "Për Arsimin e Lartë në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, si dhe në rregulloren e zgjedhjeve.

3. Në bazë të nenit 18, të ligjit nr.9741, dt.21.05.2007 "Për Arsimin e Lartë në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, Këshilli i Fakultetit ka këto funksione kryesore:

a) programon dhe përcakton, në bazë të propozimeve të departamenteve, përdorimin e burimeve njerëzore dhe materiale në dispozicion të fakultetit;

b) propozon programe të reja studimi a të kërkimit shkencor; për hapje, ndryshim ose mbyllje departamentesh a njësisish të tjera;

c) merr vendime për problemet financiare të fakultetit, në përputhje me autoritetin që i është deleguar atij;

ç)shqyrton dhe miraton në një mbledhje të hapur për personelin akademik administrativ dhe për studentët, raportin vjetor të dekanit për veprimtarinë mësimore, kërkimore dhe financiare të fakultetit;

d)i propozon senatit akademik planin strategjik të zhvillimit të fakultetit dhe mbikëqyr realizimin e tij.

4.Këshilli i Fakultetit kryen edhe këto detyra:

a) (shfuqizuar)

b)diskuton në lidhje me marrëveshjet që synohen të lidhen nga universiteti me të tretë, me interes për fakultetin, përpara se këto të miratohen në parim nga Senati Akademik dhe të nënshkruhen nga Rektori;

c)propozon për miratim në Këshillin e Administrimit, strukturën dhe numrin e punonjësve në fakultet;

ç) (shfuqizuar)

d) shpall projektet fituese, për t'u financuar nga fondet për kërkim shkencor nga buxheti i fakultetit, si dhe bursa për studime a kërkime shkencore, që administrohen nga vetë fakultetit;

e)miraton listën e periodikëve shkencorë ku do të pajtohet fakultetit, si dhe titujt e librave që do të blihen për bibliotekën e fakultetit, mbi bazën e propozimeve të bëra nga departamentet;

ë)miraton mënyrën e përdorimit të dhurimeve që janë kryer në favor të një departamenti, duke marrë parasysh propozimin e departamentit përfitues;

f) (shfuqizuar)

5.Në ushtrimin e kompetencave të tij, Këshilli i Fakultetit shprehet me vendime.

Neni 18

Organe të tjera drejtuese të Universitetit “Fan S.Noli”

Në bazë të nenit 13, pika 2, të Ligjit nr. 9741, dt.21.05.2007 “Për Arsimin e Lartë në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, Rektorati i propozon Senatit Akademik ngritjen e organeve të tjera drejtuese, të cilat janë:

a)Këshilli Shkencor dhe Botues;

b)Bordi Këshillimor.

Neni 19

Këshilli shkencor dhe botues

1.Këshilli Shkencor dhe Botues i UK-së ka si funksion kryesor nxitjen, zhvillimin dhe vlerësimin e punës kërkimore-shkencore dhe botuese të personelit akademik.

2. Anëtarët e Këshillit Shkencor dhe Botues përzgjidhen dhe emërohen prej Senatit Akademik nga punonjësit akademikë të brendshëm dhe të jashtëm me tituj shkencorë, sipas propozimeve të Rektorit.

3. Këshilli Shkencor dhe Botues përbëhet nga 12 anëtarë dhe kryesohet nga Rektori.

4. Këshilli Shkencor dhe Botues harton rregulloren e organizimit dhe zhvillimit të punës kërkimore-shkencore dhe botuese të UK-së, të cilën ia kalon për miratim Senatit akademik.

5. Mënyra e shpërblimit të anëtarëve të Këshillit Shkencor dhe Botues të UK-së bëhet sipas akteve ligjore e nënligjore në fuqi.

Neni 20

Bordi Këshillimor

1. Rektori i UK-së këshillohet herë pas here, kur ai e sheh të arsyeshme, me një bord këshillimor.

2. Në këtë bord ftohen nga Rektori të marrin pjesë: kryetari i Këshillit të Qarkut Korçë, kryetari i Bashkisë Korçë, drejtues të institucioneve publike, kryetari i Dhomës së Tregtisë dhe Industrisë, kryetari i Shoqatës së Ndërtuesve etj.

3. Rektori ka të drejtë të thërrasë në konsultë, sipas fushave të veçanta, edhe ekspertë vendës apo të huaj.

Neni 21

Autoritetet drejtuese të Universitetit “Fan S.Noli” të Korçës

Në bazë të nenit 20, pika 1 e Ligjit nr.9741, dt.21.05.2007 “Për Arsimin e Lartë në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, autoritete drejtuese në Universitetin “Fan S.Noli” të Korçës janë:

- a) rektori;
- b) dekani i fakultetit;
- c) përgjegjësi i i njësisë bazë.

Neni 22

Rektori

1.Rektori është autoriteti më i lartë drejtues i UK-së. Ai zgjidhet nga e gjithë trupa përbërëse zgjedhore e universitetit, sipas mënyrës së përcaktuar në Ligjin nr.9741, dt.21.05.2007 “Për Arsimin e Lartë në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, si dhe në rregulloren e zgjedhjeve të institucionit dhe emërohet nga Presidenti i Republikës.

2.Rektori duhet të ketë së paku titullin “Profesor i Asociuar” ose gradën shkencore “Doktor” (“PHD”), të fituar pranë universiteteve perëndimore dhe me përvojë akademike në këto universitete.

3. Rektori ka mandat 4- vjeçar dhe nuk mund të zgjidhet për më shumë se dy mandate radhazi në këtë funksion.

4.Rektori, përveç detyrave që ushtron si drejtues i rektoratit, të përcaktuara në nenin 15 të ligjit nr. 9741, dt. 21. 05. 2007 “Për Arsimin e Lartë në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, ushtron edhe këto kompetenca:

a)përfaqëson UK në marrëdhënie me të tretët;

b)është garant i autonomisë universitare brenda UK të Korçës, si dhe siguron unitetin e këtij universiteti;

c)paraqet propozimet përkatëse për aktet që janë në kompetencë shqyrtimi të Senatit Akademik, Këshillit të Administrimit, Këshillit të Etikës, si dhe Këshillit Shkencor dhe Botues;

ç)i kërkon mendim Këshillit të Administrimit për çështje të kompetencës së këtij organi;

d)ngre komisione e grupe pune për çështje, studime e veprimtari të veçanta në përputhje me ligjin për arsimin e lartë me qëllim që t’i shërbejë këtij institucioni.

dh)miraton strukturën dhe organikën e detajuar për të gjitha nivelet, bazuar në vendimin e Këshillit të Administrimit;

e)nënshkruan kontratat e punës me personelin e UK;

ë)nënshkruan diplomat e përfundimit të studimeve, pa të drejtë për ta deleguar nënshkrimin;

f)zgjidh në mënyrë përfundimtare çështjet e kompetencës mes organeve, në rast kolizioni të tyre;

g)zgjidh në mënyrë përfundimtare mosmarrëveshjet mes dekanit dhe fakultetit përkatës, apo mes dy dekanëve;

gj)ushtron kontrolle në fakultete, për cilësinë e mësimdhënies, kërkimin shkencor si dhe për çdo çështje tjetër në kompetencë të tyre;

5.Mandati i Rektorit mbaron kur:

a)përfundon afati i mandatit;

b)jep dorëheqjen;

- c) vdes;
 - ç) bëhet e pamundur nga ana fizike apo mendore që të ushtrojë funksionin;
 - d) largohet nga UK;
 - dh) në rastin e parashikuar në pikën 3, të nenit 64, të ligjit nr.9741, dt. 21. 05. 2007 “Për Arsimin e Lartë në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.
6. Marrëdhëniet e Rektorit me organet e tjera, mënyra dhe kushtet e ushtrimit të kompetencave të tij, parashikohen në rregulloren e universitetit.

Neni 23

Dekani i fakultetit

1. Dekani është drejtues i Fakultetit dhe përfaqësues ligjor i tij. Ai zgjidhet për një mandat 4-vjeçar dhe nuk mund të zgjidhet në këtë detyrë për më shumë se dy mandate radhazi. Dekani i Fakultetit zgjidhet nga personeli akademik, nga personeli joakademik dhe nga studentët e fakultetit, sipas mënyrës së përcaktuar në ligjin nr.9741, dt. 21. 05. 2007 “Për Arsimin e Lartë në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, si dhe në rregulloren e zgjedhjeve.

2. Dekani duhet të ketë të paktën titullin “Profesor i asociuar” ose gradën shkencore “Doktor”(“PHD”), të fituar pranë universiteteve perëndimore dhe me përvojë akademike në këto universitete.

3. Dekani i Fakultetit, veç pozitës juridike që përcaktohet për të në paragrafin e dytë të nenit 20 të ligjit nr.9741, dt.21.05.2007 “Për Arsimin e Lartë në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, dhe detyrat nga neni 18 të i po këtij Ligji për Këshillin e Fakultetit, ushtron edhe këto kompetenca:

a) drejton dhe kontrollon të gjithë punën mësimore e shkencore në fakultet dhe njësitë e tjera në varësi të tij;

b) ndjek zbatimin e programeve të studimit dhe të kurrikulave;

c) emëron përgjegjësit e zgjedhur të departamenteve;

ç) (shfuqizuar)

d) përgatit propozimin përkatës për vendimmarrjet e Këshillit të Fakultetit për probleme të ndryshme;

dh) përgjigjet para Këshillit të Fakultetit për mbarëvajtjen e procesit të mësimdhënies dhe të kërkimit shkencor në fakultet;

e) i propozon Këshillit të Fakultetit hapjen, mbylljen, reformimin e kurrikulave, të departamenteve apo të njërive të veçanta në fakultet;

ë) i propozon Këshillit të Fakultetit pjesëmarrjen në projekte brenda apo jashtë vendit, ofrimin e shërbimeve të ndryshme për të tretë, hapjen e qendrave, kurseve, si dhe çdo çështje në lidhje me sa më sipër;

f)ushtron kontrole për cilësinë e mësimdhënies, kërkimit shkencor, të zbatimit të kontratave të punës, si dhe të çdo detyrimi tjetër të marrë përsipër nga departamentet apo personeli i fakultetit;

g)kur me veprimet e tij, përgjegjësi i departamentit ose i çdo njësie tjetër bazë shkel rëndë ose në mënyrë të përsëritur, aktet ligjore, nënligjore, statutin dhe rregulloret e universitetit, dekani vepron sipas pikës 5 të nenit 64 të ligjit nr.9741, dt.21.05.2007 “Për Arsimin e Lartë në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.

4.Përcaktimi më i detajuar i kompetencave të dekanit bëhet në rregulloren e Universitetit.

5.Dekani largohet nga detyra kur:

a)i përfundon afati i mandatit;

b)jep dorëheqjen;

c) vdes;

ç)largohet nga universiteti;

d)bëhet e pamundur nga ana fizike apo mendore që të ushtrojë funksionin;

dh)në rastin e parashikuar në pikën 4, të nenit 64 të Ligjit nr.9741, dt.21.05.2007 “Për Arsimin e Lartë në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.

6.Dekani, në ushtrimin e kompetencave të tij, shprehet me urdhra dhe udhëzime.

Neni 24

Përgjegjësi i departamentit

1. Përgjegjësi i departamentit është autoriteti kryesor drejtues për organizimin dhe drejtimin e njësisë bazë të universitetit.

2.Përgjegjësi i departamentit zgjidhet me një mandat 4-vjeçar nga trupa akademike e njësisë bazë, mbështetur në nenin 21, pika 3/c të Ligjit nr. 9741, dt.21.05.2007 “Për Arsimin e Lartë në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, si dhe në rregulloren e zgjedhjeve.

3.Pozita juridike e përgjegjësit të departamentit, marrëdhëniet e tij me pedagogët e departamentit, me organet e tjera në fakultet, si dhe me të tretët, përcaktohen në rregulloren e universitetit.

Neni 25

Autoritete të tjera të Universitetit “Fan S.Noli” të Korçës

Autoritete të tjera të UK janë:

- a) kancelari i Universitetit;
- b) zëvendësrektori/ët;
- c) zëvendësdekani/ët.

Neni 26

Kancelari

1. Kancelari është autoritet, në përbërje të rektoratit të UK-së.

Ai është përgjegjës për drejtimin e përditshëm, administrativ dhe financiar të institucionit, për zbatimin e buxhetit, për mbikëqyrjen dhe kontrollin e veprimeve financiare, si dhe për zbatimin e ligjshmërisë.

Kancelari nuk mund të ushtrojë asnjë funksion tjetër, akademik apo administrativ, në institucion.

2. Kancelari, për përbushjen e funksioneve të tij, kryen këto detyra:

- a) Drejton veprimtarinë e administratës;
- b) Realizon administrimin financiar;
- c) Drejton planifikimin dhe realizimin e investimeve;
- ç) Mbikëqyr të gjitha procedurat e marrjes në punë;
- d) Drejton procedurat e marrjes në punë dhe vlerësimin e performancës së punonjësve të administratës;
- dh) Me autorizimin e rektorit, përfaqëson ose bashkëpërfaqëson UK-në në të gjitha proceset gjyqësore apo zgjidhjen e mosmarrëveshjeve me palët e treta, persona fizikë ose juridikë.

e) Kryeson sekretariatit teknik, që mbështet veprimtarinë e këshillit të administrimit të UK-së;

ë) Mbikëqyr zbatimin e ligjshmërisë në veprimtarinë e UK-së.

3. Kriteret kryesore që duhet të plotësojë kandidatura për kancelar janë:

- a) të ketë arsimin e lartë juridik ose ekonomik;
- b) të ketë së paku 5 vjet përvojë pune në këto specialitete;
- c) të paraqesë një platformë për administrimin ekonomik dhe financiar të universitetit.

Kritere më të hollësishme përcaktohen nga këshilli i administrimit të UK-së.

4. Për përzgjedhjen dhe emërimin e kancelarit ndiqen procedurat që

përcaktohen në Vendimin nr. 875, datë 18.06.2008 të Këshillit të Ministrave” si më poshtë:

- a) KADM-ja miraton kriteret, që duhet të plotësojnë kandidatët;
- b) Rektorati shpall publikisht, për dy javë kalendarike, vendin e punës dhe kriteret që duhet të plotësojnë kandidatët për kancelar, si dhe shpall fillimin e vlerësimit dhe të përzgjedhjes së kandidatëve, nëse janë paraqitur, së paku, tri kandidatura;
- c) KADM-ja harton skemën e vlerësimit të kandidatëve duke përkrahur me hollësi mënyrën e vlerësimit të kandidatëve, në bazë të ligjit nr.8549, datë 11.11.1999 “Statusi i nëpunësit civil”. Përveç vlerësimit të dosjes mund të parashikojë edhe një intervistë;
- ç) Çdo anëtar i KADM-së bën vlerësimin me shkrim, sipas skemës së miratuar për çdo kandidat dhe në fund, në bazë të pikëve të grumbulluara, shpallet renditja e kandidatëve;
- d) KADM-ja ka të drejtë të përzgjedhë, me votim të fshehtë, njërin nga tre kandidatët që kanë grumbulluar më shumë pikë. Fitues shpallet kandidati që merr 2/3 e votave të anëtarëve.
- dh) KADM-ja, pasi bën përzgjedhjen e kandidatëve, shpall publikisht kandidaturën fituese. Kandidatët kanë të drejtë ta ankimojnë vendimin e KADM-së, vetëm për procedurën e vendimmarrjes, brenda 3 ditëve nga data e shpalljes. Ankesat depozitohen në protokollin e institucionit. KADM-ja ka të drejtë të shqyrtojë ankesat, në përputhje me Kodin e Procedurave Administrative dhe u përgjigjet atyre me shkrim.
- e) KADM-ja, pas rishqyrtimit, ia dërgon propozimin e vet rektorit, brenda 2 ditëve pune.
- ë) Rektori, pas përfundimit të procesit të ankimit, ia përcjell Ministrit të Arsimit dhe Shkencës dosjen e kandidatit për kancelar brenda 2 ditëve pune nga data e ardhjes së propozimit, së bashku me vendimin e me relacionin shoqërues të KADM-së ku pasqyrohet i plotë edhe qëndrimi i pakicës që ka votuar kundër. Kur rektori nuk ia dërgon ministrit propozimin e KADM-së për kandidaturën për kancelar brenda afatit të mësipërm, kryetari i këtij këshilli i dërgon ministrit vendimin brenda 2 ditëve pune.
- f) Ministri i Arsimit dhe Shkencës ka të drejtë të pranojë ose refuzojë kandidaturën e propozuar, brenda 10 ditëve nga data e mbërritjes së propozimit. Në rast refuzimi të kandidaturës, përsëritet e gjithë procedura e përzgjedhjes së kancelarit të institucionit. Në rast se ministri refuzon edhe kandidaturën e propozuar herën e dytë, ai ka të drejtë të emërojë një kancelar të komanduar, për jo më shumë se 1 vit. Gjatë kësaj periudhe, KADM-ja përzgjedh një kandidaturë të re, sipas procedurave të mësipërme.
- g) Kancelari shkarkohet nga Ministri i Arsimit dhe Shkencës, me nismën e vet, me propozimin e KADM-së ose të rektorit të UK-së. Procedurat që ndiqen nga KADM-ja, për shkarkimin e kancelarit e për mënyrën e votimit, janë të njëjta me atë të ndjekura për përzgjedhjen e tij.

5.Marrëdhëniet e kancelarit me organet e tjera në rektorat dhe të Universitetit, si dhe detyra të tjera që mund t'i delegohen, përcaktohen në rregulloren e UK-së”.

Neni 27

Zëvendësrektori/ët

1.Zëvendësrektori emërohet në detyrë nga Rektori, pas miratimit të kandidaturës së propozuar prej tij në Senatin Akademik, siç përcaktohet në pikën 4, të nenit 22 të ligjit nr. 9741, dt.21.05.2007 “Për Arsimin e Lartë në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.

Ai duhet të ketë të paktën gradën shkencore “Doktor”.

2. Zëvendësrektori kryen detyrat që i përcaktohen në urdhrin e Rektorit dhe, në mungesë e më porosi të tij, nënshkruan aktet përkatëse.

3.Në rastin kur ka më shumë se një zëvendësrektor, fusha e kompetences së secilit përcaktohet me vete.

4.Marrëdhëniet e zëvendësrektorit me organet e tjera në Rektorat dhe në të gjithë universitetin përcaktohen në rregulloren e UK-së.

Neni 28

Zëvendësdekani/ët

1.Zëvendësdekani emërohet dhe shkarkohet në detyrë nga dekani, pas miratimit të kandidaturës së propozuar prej tij në Këshillin e Fakultetit, siç përcaktohet në pikën 5, të nenit 22 të ligjit nr.9741, dt.21.05.2007 “Për Arsimin e Lartë në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar. Zëvendëdekani gëzon pozitën juridike, siç përcaktohet në nenin 34 të Kodit të Procedurave Administrative.

2.Zëvendësdekani duhet të plotësojë këto kritere:

a)të jetë lektor, të paktën i një lënde, dhe në marrëdhënie pune me afat të pacaktuar në atë fakultet;

b) duhet të ketë të paktën studimet të ciklit të dytë, të nivelit “Master i Shkencave”.

3.Zëvendësdekani siguron, në mungesë të dekanit, drejtimin e punës në Fakultetin përkatës. Ai kryen detyrat që i përcaktohen në urdhrin e dekanit dhe, në mungesë e më porosi të tij, nënshkruan dokumentet përkatëse. Fusha e kompetencës e secilit zëvendësdekan, aty ku janë emëruar më shumë se një, përcaktohet me urdhër të dekanit.

Veprimtaritë e Orientimit dhe të Kujdestarisë

1.Njësitë kryesore dhe ato bazë të UK-së zhvillojnë veprimtari institucionale në këto drejtime :

- a) kujdestari (tutorat) për studentët ;
- b) këshillim për nxënësit për përzgjedhjen e programeve të studimit ;
- c) informacion mbi programet e studimit dhe mbi funksionimin e shërbimeve për studentët etj.
- d) orientim për përfshirjen në tregun e punës etj.

2. Fakultetet ndërmarrin nisma për t'u bërë të njohur nxënësve të vitit të fundit të shkollës së mesme programet e studimit që ofrojnë, strukturat përbërëse dhe shërbimet për studentët, në mënyrë që maturanët të bëjnë një zgjedhje të ndërgjegjshme dhe të motivuar të programit të studimit. Për këtë qëllim organizohen takime orientuese të programuara.

3.Këshillat e fakulteteve parashikojnë me rregullore të posaçme kujdestarinë (tutoratin) për studentët, për çdo program studimi, për të siguruar mbështetjen e studentëve për parandalimin e largimeve apo zgjatjes së kohës së studimeve përtej kohëzgjatjes normale të tyre.

Ky shërbim ka si qëllim orientimin dhe asistimin e studentëve gjatë gjithë programit të studimit, për t'i nxitur ata për një pjesëmarrje aktive në jetën universitare.

Mbrojtësi i studentëve

1.Mbrojtësi i studentëve caktohet një prej pedagogëve të fakultetit, i cili emërohet nga dekani, pas miratimit paraprak të kandidaturës së tij nga studentët që bëjnë pjesë në këshillin e studentëve të fakultetit.

2.Mbrojtësi i studentëve ka mandat 4-vjeçar dhe ka për mision përçimin e çdo problemi të studentëve te dekani, këshilli i fakultetit apo kancelari, sipas kompetencës së tyre. Nëse organi përkatës në fakultet nuk shprehet për këtë problem, mbrojtësi i studentëve i drejtohet Rektorit të UK.

3.Çdo student, si verbalisht apo me shkrim, i identifikuar apo në mënyrë anonime, ka të drejtë të vërë në lëvizje mbrojtësin e studentëve, i cili detyrohet të evidentojë në një regjistër, çdo shqetësim dhe zgjidhjen përkatëse që i është dhënë.

KREU IV

ORGANIZIMI I STUDIMEVE NË UNIVERSITETIN “FAN S.NOLI”

Neni 31

Format e studimeve

Studime në UK organizohen në këto forma:

- a) studime me kohë të plotë;
- b) studime me kohë të pjesshme;
- c) studime në distancë.

Neni 32

Programet e studimeve

1. UK ofron programe të akredituara të studimeve, të organizuara në module dhe të vlerësuara në kredite, sipas Sistemit Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS). Sasia mesatare e krediteve të grumbulluara gjatë një viti nga një student me kohë të plotë është 60 kredite.

2. Programet e studimeve hartohen nga departamentet e fakulteteve dhe i kalohen për shqyrtim Këshillit të Fakultetit, i cili ia paraqet më tej për miratim Senatit Akademik. Pas miratimit nga Senati Akademik, programet e studimeve i dërgohen për vlerësim dhe miratim të mëtejshëm Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës dhe më pas shpallen publikisht.

3. Çdo program studimi zhvillohet sipas rregullores që hartohet në bazë të udhëzimeve të dërguara nga Ministria e Arsimit dhe e Shkencës, miratuar nga Këshilli i Fakultetit.

4. Rektorati shpall publikisht programet e akredituara të studimeve që ofron, para fillimit të aplikimeve për pranime në to.

5. Senati Akademik dhe Këshillat e fakulteteve rishikojnë periodikisht rregulloret mësimore përkatëse.

Ciklet dhe titujt e studimeve universitare

1. Programet e studimeve në institucionet e arsimit të lartë organizohen në tri cikle të njëpasnjëshme: cikli i parë, cikli i dytë dhe cikli i tretë.

1.1 Studimet e ciklit të parë:

a) programet e studimeve të ciklit të parë synojnë pajisjen me njohuritë bazë, mbi metoda e parime shkencore të përgjithshme, dhe formimin e shprehive të veçanta në një llojshmëri të gjerë profesioneve e specialitetesh;

b) programet e studimeve të ciklit të parë realizohen me 180 kredite europiane (ECTS) (më tej: kredite) dhe kohëzgjatja normale e tyre është 3 vite akademike;

c) në përfundim të programeve të studimeve të ciklit të parë lëshohet diplomë universitare “Bachelor” në fushën e arsimit të kryer.

1.2. Studimet e ciklit të dytë:

1.2.1. Programet e studimeve “Master i shkencave”:

a) programet e studimeve të ciklit të dytë i pajisin të diplomuarit që zotërojnë diplomën universitare “Bachelor” me njohuri të thelluara, teorike dhe praktike, si dhe trajnim për kërkim shkencor në një fushë, brenda një specialiteti;

b) programet e studimeve të ciklit të dytë realizohen me 120 kredite, ku përfshihen 30-40 kredite për projektin kërkimor dhe tezën dhe kohëzgjatja normale e tyre është 2 vite akademike;

c) studentët e këtij programi studimi duhet të japin në përfundim edhe provimin e gjuhës angleze, mbi bazën e testeve të njohura ndërkombëtare;

ç) në përfundim të programeve të studimeve të ciklit të dytë lëshohet diplomë universitare “Master i shkencave” në fushën e arsimit të kryer.

1.2.2. Programet e studimeve “Master profesional”:

a) programet e studimeve “Master profesional” u ofrojnë të diplomuarve, me një diplomë universitare së paku “Bachelor”, arsimim dhe trajnim të mirëfilltë profesional;

b) programet e studimeve “Master profesional” realizohen me 60-90 kredite dhe kohëzgjatja normale e tyre është 1,5 (një vit e gjashtë muaj) vit akademik;

c) studentët e këtij programi studimi duhet të japin në përfundim edhe provimin e gjuhës angleze, mbi bazën e testeve të njohura ndërkombëtare;

ç) në përfundim të këtyre programeve të studimeve lëshohet diplomë universitare “Master profesional” në fushën e arsimit të trajnimit profesional të kryer;

d) UK ka të drejtë të pranojnë kandidatë që kanë fituar diplomë “Master profesional” në studimet e ciklit të dytë për diplomën universitare “Master i shkencave” dhe të vendosë kritere për njohjen/transferimin e krediteve të vlefshme të fituara në studimet e masterit që i përgjigjen programit të studimeve të ciklit të dytë.

1.3. Studimet e ciklit të tretë:

1.3.1. Programet e studimeve të doktoratës:

a) programet e studimeve të doktoratës janë programe të studimeve të ciklit të tretë, me karakter plotësisht akademik, që kanë në bazë kërkim shkencor dhe veprimtari krijuese;

b) në studimet e doktoratës pranohen kandidatë që kanë fituar diplomë universitare “Master i shkencave”;

c) këto programe të studimeve zgjasin të paktën 3 vite akademike dhe përfshijnë 60 kredite për studime të organizuara teorike. UK, në bazë të rezultateve të arritura në studimet e organizuara teorike, vendos kritere klasifikimi për kandidatët që kanë të drejtë të zhvillojnë projektin kërkimor dhe të përgatisin tezën e doktoratës. UK përcakton standarde e kritere kualifikuese për njohjen e gjuhës angleze, mbi bazën e testeve të njohura ndërkombëtare, si dhe metoda për vlerësimin e nivelit teorik të përgjithshëm të kandidatëve. Kandidatët, që nuk arrijnë të përmbushin kriteret e vendosura, nuk klasifikohen për të vazhduar më tej studimet e doktoratës dhe pajisen me një dëshmi, në të cilën jepen modulet e zhvilluara së bashku me kreditet e grumbulluara dhe vlerësimin e tyre;

ç) në përfundim të programeve të studimeve të doktoratës lëshohet diploma për gradën shkencore “Doktor” (Dr).

2. UK ofron programe të studimeve të ciklit të dytë dhe të ciklit të tretë vetëm në ato fusha, ku plotëson kriteret dhe përmbush standardet shtetërore, në përputhje me ligjin nr.9741, dt.21.05.2007 “Për Arsimin e Lartë në RSH”, i ndryshuar.

3. Programet e studimeve të ciklit të parë, të ciklit të dytë dhe të ciklit të tretë janë programe të studimeve universitare.

4. UK ka të drejtë të ofrojë edhe programe të studimeve jouniversitare, profesionale, pas arsimit të mesëm, me jo më pak se 120 kredite. Kohëzgjatja normale e këtyre programeve është jo më pak se 2 vite akademike dhe në përfundim të tyre lëshohet “Diplomë profesionale” në fushën e arsimit të kryer. Kreditet e akumuluar gjatë studimeve pas arsimit të mesëm mund të transferohen në studimet universitare të ciklit të parë, në përputhje me kriteret që vendos vetë universiteti.

Neni 34

Pranimi në ciklin e parë të studimeve

1.Çdo person që ka përfunduar me sukses Maturën Shtetërore, ka të drejtë të kandidojë për t’u pranuar në ciklin e parë të studimeve të UK.

2.Ciklin e parë të studimeve në UK mund ta ndjekin edhe studentë të huaj, bazuar në marrëveshjet dypalëshe ose shumëpalëshe.

3.Ciklin e parë të studimeve mund ta ndjekin edhe shtetas shqiptarë e të huaj që kanë përfunduar studimet e larta (program i dytë studimi), kundrejt pagimit të tarifës së caktuar.

4. UK, si institucion i arsimit të lartë, ka të drejtë të propozojë kritere të veçanta për përzgjedhjen e kandidatëve, të cilët kanë mbaruar Maturën Shtetërore, për t’u pranuar në ciklin e parë të studimeve. Këto kritere shqyrtohen dhe vlerësohen nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës, në këshillim me Konferencën e Rektorëve dhe

Këshillin e Arsimit të Lartë dhe Shkencës dhe, mbi këtë bazë, ministri miraton, me udhëzim, kriteret dhe procedurat e pranimit në ciklin e parë të studimeve.

Neni 35

Pranimi në ciklin e dytë dhe të tretë të studimeve

1. Në UK kanë të drejtë të aplikojnë për t'u regjistruar në ciklin e dytë të studimeve, individë që kanë përfunduar një program studimi të ciklit të parë, si dhe plotësojnë standardet akademike të kriterëve të pranimit.

2. Kanë të drejtë të aplikojnë për t'u regjistruar në ciklin e tretë të studimeve kandidatë që kanë fituar diplomë universitare "Master i shkencave" ose një diplomë ekuivalente me të, si dhe plotësojnë kriteret e pranimit, të përcaktuara nga UK.

3. Kriteret e pranimit për standardet akademike të përzgjedhjes së kandidatëve për t'u pranuar në programet e ciklit të dytë, si dhe të ciklit të tretë të studimeve përcaktohen në rregulloren mësimore të çdo programi studimi, ku kriteri bazë është nota mesatare, e çdo cikli të mëparshëm studimi.

Neni 36

Viti akademik dhe organizimi i mësimdhënies

1. Studimet në UK zhvillohen me bazë vitin akademik, i cili organizohet në semestra me së paku 20 orë mësimi në javë, ku përfshihen leksione, seminare e laboratore.

2. Organizimi i mësimdhënies për programet e studimeve të formimit të vazhduar, përcaktohet në rregulloren e universitetit.

Neni 37

Ndjekja e një programi të dytë studimi

1. UK ofron mundësinë e kryerjes së programeve të dyta të studimit në ciklin e parë pas përfundimit të studimeve në një nga programet e studimit të këtij Universiteti apo jashtë tij.

2. Pranimi bëhet duke u mbështetur në kuotat e miratuara nga Këshilli i Ministrave.

3. Pranimi i kandidatëve bëhet mbi bazën e kritereve përzgjedhëse të meritës të përcaktuara nga Fakulteti dhe kundrejt tarifës së caktuar.

4. Personat që kanë përfunduar një program studimi, kanë të drejtë të ndjekin një program të dytë studimi dhe në këtë rast përballojnë vetë koston e plotë të studimeve. Nga ky rregull përjashtohen studentët e shkëlqyer.

5. Në mënyrë më të detajuar, kriteret e pranimit në një program të dytë studimi përcaktohen në Rregulloren e Studimeve të universitetit.

Neni 38

Transferimet

1. UK pranon transferime studentësh në vite të ndërmjetme nga universitete të tjera, në të njëjtin program apo formë studimi dhe lejon largimin e studentëve të tij për në universitete të tjera, sipas procedurave të parashikuara në Rregulloren e Studimeve të Universitetit.

a. (shfuqizuar)

b. Transferimi është i mundur pas përfundimit të njohjes së periudhave të studimit dhe ekuivalentimit.

c. Procedurat transferuese përfundojnë një muaj para fillimit të vitit akademik.

2. Vendimi për njohjen e plotë ose të pjesshme të krediteve të grumbulluara nga një student me qëllim transferimin e programit të studimeve, i takon Fakultetit që pranon studentin, sipas kritereve të përcaktuara në Statut dhe në Rregulloren e Studimeve të Universitetit.

Neni 39

Pajisja me diplomë

Me përfundimin e studimeve universitare në UK fitohen diploma:

- a) Në Fakultetin e Bujqësisë
- b) Në Fakultetin e Ekonomisë
- c) Në Fakultetin e Edukimit dhe Filologjisë
- d) Në Fakultetin e Shkencave Natyrore dhe Shkencave Humane

Neni 40

Njohja dhe ekuivalentimi i diplomave dhe i periudhave të studimeve

1. UK bën ekuivalentimin e pjesëve ose programeve të plota të studimit ose diplomave të marra në institucione të tjera të vendit ose të huaja, në një program të njëjtë studimi ose të ngjashëm mbas paraqitjes së kërkesës dhe dokumentacionit përkatës nga të interesuarit.

2. Pranë çdo departamenti, me vendim të Këshillit të Fakultetit, ngrihet dhe funksionon Komisioni i Njohjes dhe Ekuivalentimit të Programeve të Studimeve. Kriteret e ngritjes dhe funksionimit të këtyre Komisioneve përcaktohen në rregulloret e programeve të studimit.

3. Procedurat dhe kërkesat për ekuivalentim përcaktohen në rregulloren mësimore të çdo programi studimi, në përputhje me udhëzimet e Ministrisë së Arsimit.

Neni 41

Viti akademik sabatik

1. Personeli akademik me tituj i UK ka të drejtë, që çdo 7 vjet, për periudha kohe deri në një vit, të punojë për përparimin e tij akademik.

2. Gjatë kësaj periudhe, personelit akademik nuk i ngarkohet detyrë mësimdhënieje. Personeli akademik mund të ndjekë gjatë këtij viti edhe kurse specializimi deri tremujore, jashtë institucionit pas miratimit të këshillit të fakultetit përkatës.

3. Midis të interesuarit dhe Rektoratit të UK, nënshkruhet një kontratë e posaçme, elementet e së cilës vendosen me një akt nënligjor të Rektorit.

4. Autoritetet drejtuese të universitetit nuk kanë të drejtë për vit sabatik gjatë kohës së ushtrimit të mandatit si drejtues, i zgjedhur apo i emëruar.

Neni 42

Vlerësimi moral për studentët

1. Studentët që, në përfundim të studimeve të plota, kanë të gjitha notat dhjeta, fitojnë “Medalje të Artë” me certifikatën përkatëse; ata që kanë jo më pak se 70% të notave dhjeta dhe pjesën tjetër nënta, fitojnë certifikatën “Student i Shkëlqyer”.

2. Dorëzimi i diplomave bëhet me ceremoni në çdo fakultet. Për studentët që fitojnë “Medalje të Artë” ose Certifikatën “Student i Shkëlqyer”, ceremonia organizohet në shkallë universiteti dhe dorëzimi i diplomave bëhet personalisht nga Rektori, në prani të përfaqësuesve të Senatit Akademik, të profesoratit, administratës dhe studentëve.

Neni 43

Norma mësimore dhe mbingarkesa

1. Mësimdhënia është detyrim me së paku 6 orë mësim në javë, në auditor për të gjithë personelin akademik. Ngarkesa e plotë për personelin akademik përcaktohet me Udhëzim të Ministrit të Arsimit dhe Shkencës.

2. Personelit akademik i njihet e drejta e pagesës së orëve të realizuara mbi normën, sipas akteve ligjore e nënligjore në fuqi.

KREU V

KËRKIMI SHKENCOR

Neni 44

Kërkimi shkencor dhe financimi i tij

1. UK-ja kryen veprimtari shkencore bazë dhe të aplikuar në funksion të rritjes së cilësisë së arsimit, të aftësisë së studentëve me metodologji bashkëkohore për kërkim, të plotësisë së disiplinave me njohuri shkencore dhe praktike të avancuara, si dhe të krijimit të mjeteve materiale për zhvillimin e njësisë kryesore të tij.

2. Kërkimi shkencor dhe financimi i tij bëhen mbi bazën e planeve, programeve e projekteve të miratuara në këshillat e fakulteteve dhe në Senatit Akademik të UK-së, në bazë të Strategjisë Afatgjatë për Zhvillimin e Universitetit “Fan S. Noli”, të miratuara në MASH.

3. Personeli akademik i UK ka të drejtë të aplikojë në Sektorin e Kërkimit Shkencor dhe Projekteve pranë Rektoratit të UK-së për fonde nga buxheti i universitetit, për kërkim shkencor.

4. Kriteret për përfitimin e financimeve për çdo vit miratohen nga Senati Akademik dhe shpallen në Rektorat e fakulteteve, si dhe në faqen përkatëse të internetit.

5. Brenda muajit prill të çdo viti akademik shpallen fituesit që përfitojnë financim të plotë apo të pjesshëm për kërkimin shkencor.

6. Me përfituesit e këtyre financimeve lidhet një kontratë e posaçme, në të cilën parashikohen të drejtat dhe detyrimet mes tyre dhe UK-së.

7. Sektori i Kërkimit Shkencor dhe Projekteve përpilon një raport vjetor për veprimtarinë kërkimore-shkencore dhe ia paraqit Senatit Akademik të Universitetit dhe Këshillit të Administrimit, që vlerësojnë performancën e gjithë punës kërkimore-shkencore.

Neni 45

Kërkimi shkencor dhe shërbimet për të tretë

1. Personeli akademik i Universitetit të Korçës është i lirë të kryejë veprimtari kërkimi e zhvillimi për të tretë, por me kusht:

a) plotësimin e detyrimeve ndaj universitetit, sipas kontratës së punës;

b) plotësimin e detyrimeve të njësisë përbërëse të universitetit për kërkim shkencor, sipas pikes 1 të nenit 69 të ligjit nr. 9741, dt. 21. 05. 2007 “Për Arsimin e Lartë në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.

2. Kur fakultetet propozojnë të ofrojnë kërkim shkencor, shërbime, etj., për të tretë, ndiqet procedura e miratimit, e parashikuar në nenin 13, pika 6, shkronja “e”, e këtij statuti.

3. E njëjta procedurë ndiqet edhe kur, kërkimi shkencor apo shërbimet e ndryshme ofrohen në bashkëpunim me institucionet e tjera shtetërore apo private, dhe UK duhet të kontribuojë me financim. Në raste të tilla nuk zbatohet procedura e parashikuar në nenin 44, të këtij statuti.

4. Kur nga ofrimi i kërkimit shkencor apo shërbimeve për të tretët krijohen të ardhura, një pjesë e tyre mund të përdoren për shpërblimin dhe motivimin e personelit pjesëmarrës në këto veprimtari, sipas përcaktimeve në rregulloren e brendshme për administrimin, financat dhe kontabilitetin, bazuar në legjislacionin në fuqi.

KREU VI

PERSONELI I UNIVERSITETIT

Neni 46

Struktura dhe organika

1. Këshilli i Administrimit miraton strukturën e personelit të ndarë në kategori: personel akademik, personel ndihmës-mësimor dhe personel administrativ, si dhe numrin e tyre për secilën pjesë përbërëse të UK-së, bazuar në numrin e përgjithshëm të personelit të UK-së, të miratuar nga Ministri i Arsimit dhe i Shkencës.

Neni 47

Procedura e punësimit

1. Marrja në punë e personelit në UK kryhet me konkurrim publik.

2. Për vendet e lira në Rektorat konkurrimi shpallet nga ky institucion, duke përcaktuar kriteret e përgjithshme dhe të veçanta. Për vendet e lira në fakultete, dekani përkatës përgatit kriteret e përgjithshme dhe të veçanta, të cilat ia njofton Rektoratit. Rektorati bën shpalljet përkatëse.

3. Dekani i fakultetit përkatës ngre komisionin ad hoc të konkursit publik për vlerësimin e kandidaturave për punësimin e personelit akademik, i përbërë nga 5 antarë. Në komision, marrin pjesë zv/rektori, Përgjegjësi i Degës së Burimeve Njerëzore dhe Përgjegjësi i Departamentit.

4. Për emërimin e personelit akademik, dekani i fakultetit përkatës i paraqet rektorit kandidatin e renditur i pari në klasifikimin e bërë nga komisioni ad hoc i konkursit publik. Rektori lidh kontratë pune me kandidatin e përzgjedhur, mbështetur në ligjin nr.9741, dt.21.05.2007 "Për Arsimin e Lartë në RSH", i ndryshuar dhe në Kodin e Punës të Republikës së Shqipërisë. Kontrata duhet të përmbajë përshkrimin e vendit të punës dhe detyrimin e personelit akademik, sipas përcaktimeve të pikës 1 të nenit 47 të ligjit të mësipërm.

4. Kontratat e punës nënshkruhen nga Rektori, në emër dhe për llogari të punëdhënësit: UK-së

5. Shpallja e vendeve të lira dhe procedura e konkurrimit për personelin administrativ kryhen nga dekani i fakultetit, ku ata punësohen, ndërsa kontrata e punës nënshkruhet nga Rektori.

6. Mënyra e zhvillimit të konkurrimit, kriteret e unifikuara sipas kategorizimit të funksioneve, si dhe çështjet e tjera të detajuara të punësimit, parashikohen në rregulloren e UK-së.

Neni 48

Të drejtat e personelit akademik

Personeli akademik në UK ka këto të drejta:

- 1.të ushtrojë funksionin mësimdhënës dhe të kërkimit shkencor, në liri të plotë akademike;
- 2.të ketë një punë të garantuar;
- 3.të mos cenohet, pengohet apo kufizohet në çfarëdo forme, gjatë ushtrimit të funksioneve të tij;
- 4.të paguhet sipas kualifikimeve shkencore, për orët shtesë, për çdo punim, shërbim apo detyrë tjetër, për të cilën institucioni ka krijuar të ardhura;
- 5.të kryejë lejën vjetore të paguar;
- 6.çdo 7 vjet, t'i jepet e drejta e vitit akademik sabatik;
- 7.të kryejë kualifikime shkencore periodike, afatshkurtra apo afatgjata, brenda apo jashtë vendit;
- 8.të kryejë detyra të tjera jashtë funksionit bazë, pa shkaktuar konkurrencë apo konflikt interesi me UK.

Neni 49

Veprimtaria e personelit akademik

1. Personeli akademik në përbërje të fakulteteve dhe departamenteve, quhet personel akademik në Institucionet e Arsimit të Lartë publik. Ky personel kryen veprimtari mësimore, kërkimore, si dhe veprimtari të tjera në ndihmë të këtyre proceseve, të cilat zhvillohen në raport me misionin e njësisë ku bëjnë pjesë dhe në përmbushje të Ligjit nr.9741, datë 21.5.2007, i ndryshuar, si dhe të “Kodit të Punës të Republikës së Shqipërisë”.

2. Personeli akademik ka këto detyrime:

a)të zbatojë legjislacionin në fuqi për arsimin e lartë, gjatë ushtrimit të detyrës;

b)të përmbushë detyrën e ngarkuar si: ngarkesën mësimore, kërkimin shkencor etj., sipas përcaktimeve në kontratën e punës;

c)të ketë marrëdhënie bashkëpunimi me kolegët dhe studentët.

3. Personeli akademik i punësuar me kohë të plotë në institucion, ka të drejtë, me miratimin e titullarit të njësisë kryesore dhe të institucionit, të angazhohet si personel akademik i ftuar me kohë të pjesshme, në një institucion tjetër të arsimit të lartë, publik ose privat, brenda dhe jashtë vendit.

Autoritetet drejtuese, rektor, dekan dhe ato të njësuar me to, nuk kanë të drejtë të angazhohen me kohë të plotë në veprimtari mësimdhënëje, kërkimi apo në veprimtari të tjera në institucionet e tjera të arsimit të lartë, publik ose privat, brenda ose jashtë vendit, përveçse, me kohë të pjesshme pas miratimit, përkatësisht, të Ministrit të Arsimit dhe Shkencës ose të rektorit.

Neni 50

Personeli ndihmës mësimor-shkencor dhe administrativ

1. Personeli ndihmës mësimor-shkencor, si dhe personeli administrativ, ka pozitën juridike që përcaktohet në rregulloren e UK-së.

2. Të drejtat dhe detyrimet konkrete të tyre përcaktohen në kontratën individuale të punës.

Neni 51

Personeli akademik i ftuar

1. Për të plotësuar nevojat e procesit mësimor, këshillat e fakulteteve, me propozim të departamenteve, ftojnë për veprimtari mësimore e kërkimore personel akademik, sipas kërkesave të vendit të punës, për periudha semestrale ose njëvjeçare të përsëritshme.

2. Punonjësit akademikë të ftuar duhet të kenë si rregull gradën shkencore “Doktor”. Kritere më të hollësishme për përzgjedhjen e personelit akademik të ftuar, përcaktohen në rregulloren e studimeve të universitetit.

3. Përgjegjësi i departamentit përkatës, pas miratimit nga Këshilli i Fakultetit, i paraqet dekanit të fakultetit numrin e personelit akademik për t’u ftuar, lëndët përkatëse, si dhe orët mësimore që do të kryejnë.

4. Dekani i njofton Rektoratit numrin e personelit akademik të ftuar, si dhe kriteret që duhet të plotësojnë ata. Rektorati shpall vendet e lira, sipas procedurës së parashikuar në nenin 47 të këtij statuti.

5. Kontrata e punës me personelin akademik të ftuar nënshkruhet nga Rektori, në emër dhe për llogari të UK-së.

6. Punonjësit mësimorë të huaj pranohen në procesin mësimor me propozim dhe vendim të Senatit të Universitetit.

Neni 52

Personeli akademik me kontratë

1. UK ka të drejtë të punësojë me kontratë personalitete, vendase ose të huaja, për periudha të shkurtra kohe. Te kjo kategori përfshihen edhe studiues, artistë dhe

personalitete me kontribut të shquar jashtë vendit. Ky personel punësohet me vendim të Senatit Akademik, sipas propozimeve të njësive kryesore.

2. Autoritetet drejtuese të njësive kryesore, me propozimin e përgjegjësve të njësive bazë dhe të titullarit të grupit mësimor kërkimor, për të plotësuar nevojat e institucionit, punësojnë personel akademik me kohë të plotë për veprimtari mësimore e kërkimore, për periudha semestrale ose njëvjeçare të përsëritshme, sipas kërkesave të vendit të punës.

3. UK ka të drejtë të punësojë, mbi bazën e një kontrate të përkohshme, edhe studentë në procesin e kryerjes së studimeve të doktoratës dhe të përgatitjes së disertacionit për gradën shkencore “Doktor”, të cilët mbështesin profesorët udhëheqës të disertacionit në procesin mësimor dhe gjatë kësaj periudhe trajtohen si “Lektor”.

4. Personeli akademik me kontratë të ketë përvojë të gjatë mësimdhënieje ose pune në specialitetin e kërkuar, të ketë bërë publikime, botime dhe kërkime shkencore dhe pedagogjike në fushat e disiplinave që do mbulojë.

5. Paga e personelit akademik me kontratë përcaktohet, bazuar në aktet ligjore e nënligjore përkatëse.

6. Kontrata e punës me këtë personel akademik nënshkruhet nga Rektori, në emër dhe për llogari të Universitetit të Korçës.

Neni 53

Masat disiplinore

1. Shkeljet konkrete, lloji i masës disiplinore për secilën shkelje dhe institucioni që i jep ato, përcaktohen në rregulloren e UK-së.

2. Ndërprerja e marrëdhënieve të punës të personelit akademik bëhet vetëm pasi është marrë mendimi i titullarit të grupit mësimor kërkimor, si dhe i autoriteteve drejtuese të njësisë bazë e të njësisë kryesore të institucionit, përjashtuar rastet e shkeljes flagrante të Kodit të Punës dhe të etikës akademike.

Neni 54

Zgjidhja e kontratës së punës

Kontrata e punës së personelit përfundon kur:

a) jep dorëheqjen;

b) mbush moshën e pensionit të pleqërisë;

c) bëhet i paaftë nga ana fizike apo mendore për të ushtruar detyrën;

ç) dënohet me vendim penal të formës së prerë nga gjykata, me heqje lirie;

d) merr masën disiplinore të largimit nga detyra.

Zgjidhja e mosmarrëveshjeve të punës.

1. Nëse lind një mosmarrëveshje gjatë apo në përfundim të detyrës mes personelit dhe punëdhënësit, secili prej tyre ka të drejtë të kërkojë zgjidhjen e saj me pajtim, ose t'ia nënshtrojë për shqyrtim tre arbitrave. Arbitrat caktohen nga Senati Akademik nga anëtarët e tij.

Mosmarrëveshjet që palët mund t'ia nënshtrojnë procedurës së arbitrazhit janë ato që mund të lindin nga mosrespektimi prej çdonjërës prej tyre, i kushteve të përcaktuara në kontratën e punës të lidhur midis Universitetit "Fan S. Noli", në cilësinë e punëdhënësit dhe çdo anëtari të personelit të këtij universiteti, në cilësinë e punëmarrësit.

2. Pas miratimit nga ana e palëve të arbitrave të zgjedhur nga Senati Akademik, këta të fundit nisin procedurën me njohjen dhe administrimin e pretendimeve të palëve dhe të provave lidhur me to dhe nëse kërkohet prej tyre u lënë kohë për t'i sjellë ato. Në seancën e caktuar, pas dëgjimit të palëve dhe mbledhjes së provave arbitrat tërhiqen për të diskutuar dhe vendosur. Vendimi i marrë duhet të jetë i argumentuar dhe i bazuar në ligjin nr.9741, dt.21.05.2007, "Për Arsimin e Lartë në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, legjislacionin e punës në fuqi, akte të tjera ligjore e nënligjore, si dhe në Statutin dhe rregulloret e Universitetit "Fan S. Noli" Korçë.

3. Palët mund t'i drejtohen Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë, nëse mosmarrëveshjet e tyre nuk ia nënshtrojnë procedurës së arbitrazhit.

KREU VII

STUDENTËT

Neni 56

Statusi i studentit

Studenti e fiton cilësinë si i tillë me regjistrimin në UK dhe e humbet, me marrjen e diplomës nga ana e tij, si dhe në raste të ndryshme të çregjistrimit të tij.

Neni 57

Të drejtat e studentëve

Studentët, gjatë ndjekjes së studimeve në UK, kanë të drejtë:

- 1.të ndjekin leksione, seminare dhe të gjitha veprimtaritë e organizuara, në përputhje me statusin e tyre.
- 2.të zgjedhin dhe të zgjidhen në organet drejtuese të Universitetit të Korçës, të parashikuara për pjesëmarrjen e studentëve, në përputhje me Ligjin nr.9741, dt.21.05.2007 “Për Arsimin e Lartë në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar;
- 3.të përdorin të gjitha instalimet dhe pajisjet e institucionit, për kryerjen e punës mësimore, sipas programeve e rregulloreve përkatëse, të përdorin bibliotekat e mjediset sportive, kulturore e informative të Universitetit të Korçës;
- 4.të përfitojnë bursë studimi, kur plotësojnë kushtet e percaktuara nga Këshilli i Ministrave, si dhe shpërblime të veçanta që administrohen nga UK;
- 5.të organizohen në shoqata studentore jopolitike, duke iu përmbajtur përcaktimeve të akteve ligjore e nënligjore përkatëse;
- 6.të zgjedhin dhe të zgjidhen në Këshillin e Studentëve të fakulteteve përkatëse, si dhe në atë në nivel institucioni;
- 7.të pajisen me Kartën e studentit;
- 8.të shprehin opinionin e tyre për cilësinë e mësimdhënies dhe punën e personelit akademik të institucionit;

Neni 58

Detyrimet e studentëve

Studentët kanë këto detyrime:

- a)të zbatojnë rregullat e hartuara nga institucioni;
- b)t'i kushtojnë vëmendjen e duhur studimeve dhe të marrin pjesë në veprimtaritë akademike;
- c)të paguajnë tarifat e shkollimeve dhe të shërbimeve që u ofron universitetit;
- ç)të respektojnë kodin e etikës, të përcaktuar në Statutin apo rregulloret e UK-së;
- d) të tregojnë vemendjen e duhur ndaj të drejttave të personelit dhe të studentëve të tjerë.

Këshillat e studentëve

1. Në UK krijohen Këshillat e studentëve, të cilat promovojnë dhe koordinojnë pjesëmarrjen e studentëve dhe përfaqësimin e tyre në organet drejtuese të universitetit, si dhe në strukturat mësimore-kërkimore dhe në ato të shërbimeve.

2. Këshillat e studentëve krijohen në nivel fakulteti e institucioni dhe zgjidhen çdo 2 vjet nga votat e studentëve, mbështetur në legjislacionin në fuqi. Në rastet kur një individ i zgjedhur në këshillat e studentëve përfundon studimet universitare, ai zëvendësohet nga kandidati pasardhës në renditje për nga numri i votave të grumbulluara në zgjedhjet e fundit.

3. Këshilli i Studentëve i fakultetit zgjidhet me votim nga të gjithë studentët e atij fakulteti. Ai duhet të ketë në përbërje të tij përfaqësues të studentëve nga të gjitha programet e studimit, sipas fakultetit përkatës.

4. Këshilli i Studentëve i Universitetit zgjidhet me votim nga të gjithë studentët. Ai duhet të ketë në përbërje të tij përfaqësues të studentëve nga të gjitha fakultetet. Kandidatet për anëtar të Këshillit të Studentëve të Universitetit, përzgjidhen nga anëtarët e Këshillave të Studentëve të Fakulteteve, sipas procedurës së përcaktuar në rregulloren e universitetit.

5. Në mënyrë të detajuar, modalitetet dhe procedurat për krijimin, organizimin dhe funksionimin e këtyre këshillave, përcaktohen në rregulloren e universitetit.

Regjistri i studentëve

1. UK mban regjistrin bazë të studentëve me numrin e matrikullimit (NIM) të përbërë nga 6 gërmat sipas regjistrit përkatës dhe 6 shifrat e numrit të studentit në regjistrë. Fakultetet përgatisin rregulloren përkatëse të sistemit të matrikullimit, organizimin e punës dhe përgjegjësiive institucionale, sistemin e masave për sigurinë e të dhënave dhe monitorimin sistematik.

2. Sekretaria mësimore e çdo fakulteti mban të dhënat personale të studentëve, vlerësimet e marra gjatë ndjekjes së programit të studimit, të dhëna mbi diplomën ose diplomat e marra, bashkë me suplementin e diplomës etj., të formatuara sipas standardeve shtetërore.

3. Regjistrat e studentëve organizohen në bazë Fakulteti, cikli studimi dhe forme studimi plotësohen në forma të shkruara dhe elektronike dhe mbahen në ruajtje të përhershme.

KREU VIII

SIGURIMI I BRENDSHËM I CILËSISË

Neni 61

UK-ja është përgjegjës për sigurimin e brendshëm të cilësisë dhe ngre njësinë përkatëse për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë.

Neni 62

1.Njësia për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë bën vlerësimin periodik të efikasitetit të veprimtarive mësimore, shkencore, si dhe veprimtarinë administrative dhe financiare të UK-së. Ajo funksionon në bazë të një rregulloreje të veçantë.

2.Njësia për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë ka autonomi operative dhe akses në të dhënat e UK-së.

3.Njësia për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë bashkëpunon me Agjencinë Publike të Akreditimit të Arsimit të Lartë për probleme që lidhen me standardet, me udhëzimet për vlerësimin e brendshëm, me kualifikimin e anëtarëve të Njesisë etj.

4. Për veprimtarinë e saj, si dhe për probleme që lidhen me vlerësimin e brendshëm, Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë informon Senatin Akademik të UK-së.

Neni 63

1.Përbërja e Njesisë së Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë miratohet nga Senati Akademik mbi bazën e propozimeve të Rektoratit të UK-së.

2.Në Njësinë për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë marrin pjesë: nga një përfaqësues i njësive kryesore të UK-së, një përfaqësues i qeverisë studentore dhe një ekspert i jashtëm.

3.Anëtarët e Njesisë për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë, përfaqësues të njësive kryesore të UK-së, si rregull duhet të kenë të paktën shkallën e kualifikimit “Master i Shkencave” dhe të jenë njohës të problemeve të arsimit të lartë.

4.Mënyra dhe sasia e shpërblimit të anëtarëve të Njesisë për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë përcaktohen me vendim të Këshillit të Administrimit sipas akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi.

KREU IX

AUTONOMIA FINANCIARE

Neni 64

Hartimi i buxhetit

1. Çdo fakultet i UK-së deri në fund të muajit qershor paraqet në rektorat projektbuxhetin e tij për vitin pasardhës.
2. Kancelari, pasi përpunon të gjitha propozimet e ardhura, ia paraqet për shqyrtim dhe më pas për miratim Senatit Akademik dhe Këshillit të Administrimit.
3. Të ardhurat e krijuara nga UK evidentohen si e ardhur jashtë limitit (me strukturë të veçantë buxhetore) dhe mbarten në vitin buxhetor pasardhës mbi bazën e rakordimit që bën institucioni me degën e thesarit.
4. Të ardhurat e krijuara nga UK derdhen 100 % në llogarinë e institucionit dhe përdoren nga vet ai, sipas rregullave të përcaktuara.
5. Mënyra e përdorimit të fondeve të krijuara përcaktohet me rregullore të veçantë, duke respektuar rregullat financiare të përcaktuara nga ligjet e shtetit.

Neni 65

Niveli vertikal i autonomisë financiare

Mënyra e përdorimit të të ardhurave nga UK, fakultetet e departamentet, përcaktohen në përputhje me ligjin nr. 9741, dt. 21. 05. 2007 « Për Arsimin e Lartë në Republikën e Shqipërisë, i ndryshuar, dhe ligjin organik për buxhetin dhe kontabilitetin.

Neni 66

Kontrolli financiar

1. Rektorati përfshin në strukturën e tij një njësi të kontrollit të brendshëm financiar.
2. Kontrollat financiare kryhen të bazuara në programet e hartuara nga Këshilli i Administrimit apo Rektori.

KREU X

DISPOZITA KALIMTARE DHE TË FUNDIT

Neni 67

Miratimi i rregulloreve

1. Brenda 1 muaji nga data e miratimit të këtij statuti, nga Ministri i Arsimit dhe Shkencës, apo brenda 1 muaji nga mbarimi i afatit 2-mujor për t'u shprehur Ministri, Senati Akademik i UK miraton rregulloren e Universitetit të Korçës, bazuar në legjislacionin në fuqi dhe në këtë statut.

2. Rregulloret e tjera të parashikuara nga ligji dhe ky statut, miratohen nga organet përkatëse, brenda 1 muaji nga miratimi i rregullores së universitetit.

Neni 68

Hyrja në fuqi

1. Ky statut hyn në fuqi me shpalljen e tij nga Rektori i UK-së, të nesërmen e datës së miratimit nga Ministri i Arsimit dhe Shkencës, apo të nesërmen e datës së mbarimit të afatit 2-mujor për t'u shprehur Ministri.

2. Nëse Ministri e kthen këtë statut për ripunim në Senatin Akademik, për shkelje të ligjshmërisë, atëhere brenda 5 ditëve nga kthimi i statudit, Senati Akademik mblidhet për të shqyrtuar dhe miratuar ndryshimet përkatëse. Edhe në këtë rast procedura është e njëjtë me atë të përcaktuar në pikën 2, të nenit 39, të ligjit nr. 9741, dt. 21. 05. 2007 "Për Arsimin e Lartë në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar.

MIRATUAR:

SENATI AKADEMIK

KRYETARI

Prof.as.dr. GJERGJI MERO

Aneks

1. UK ka vulën zyrtare sipas modelit të miratuar nga Këshilli i Ministrave. Vula ka diametrin 38 mm, me stemën shtetërore në qendër dhe rreth saj shënohet: Republika e Shqipërisë (sipër) dhe Universiteti "Fan S. Noli" (poshtë).

2. UK ka vulën e thatë sipas modelit të miratuar nga Senati Akademik. Vula ka diametër 38 mm me pamjen e godinës kryesore në qendër, dy degë dafine anash dhe rreth saj shënohet: Universiteti "F. S. Noli" Korçë (sipër) dhe 1971 (poshtë).

3. UK ka për simbol të tij stemën e mëposhtme:



4. UK ka për simbol flamurin dhe hymnin e tij të miratuar nga Senati Akademik.